

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Studentët marshojnë sot në Prishtinë kundër vendimit të Speciales, thirrje për unitet dhe drejtësi
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/studentet-marshojne-sot-ne-prishtine-kunder-vendimit-t-e-speciales-thirrje-i587366
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	21 shtator 2026, 06:22:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 06:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	35de4d60072ccf4a9aa61a69b2606946dd62fd609e6a5309a0762316810fe9bd
TEKSTI	b53e62694562696aa1f95f98baa9185781fbaf04d41afc75af1698a7c1a1bc58
PAMJA	05a3b98f06622ad5b9b6d99ab863f1bb95acecb23a78131bf807814548c4ccd8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	70aeafb1da7523790cce50abf331e704ec45bebbc6c62029f2beb1751f02fbab
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af35c6566c3aad3783a58e2d1a9e53ca15a19073105bf934d046e340151e749d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/70aeafb1da7523790cce50abf331e704ec45bebbc6c62029f2beb1751f02fbab>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



ie [Studentët marshojnë sot në Prishtinë kundër vendimit të Speciales, thirrje për unitet dhe drejtësi](#)[Aksident me vdekje në aksin Elibasan-Peqin](#)[Atentati në Sarandë/ Dysheo](#)
fundit

Studentët marshojnë sot në Prishtinë kundër vendimit të Speciales, thirrje për unitet dhe drejtësi



21 Shtator 2026, 08:20Rajoni TEMA



Pas vendimit të Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të UÇK-së, studentët e Universitetit të Prishtinës, së bashku me studentë të universiteteve të tjera, kanë paralajmëruar marsh paqësor sot në Prishtinë.

Thirrja e tyre është për unitet e drejtësi.

Përmes një konference për media, të dielën, nga Parlamenti Studentor i Universitetit të Prishtinës, ata kanë shpallur planin e protestës, që pritet të nisë në orën 11:30 nga Qendra e Studentëve dhe të vazhdojë drejt sheshit "Skënderbeu".

Flon Kastrati ftoi të gjithë studentët, rininë dhe qytetarët t'i bashkohen marshit paqësor, ndërsa njoftoi do të shpalojë edhe një memorandum prej gjashtë pikash.

"Ky marsh është thirrje për unitet dhe e ka në qendër unitetin si e vetmja zgjidhje deri në fjalën e fundit të drejtësisë. Studentët e UP-së, së bashku me universitetet e tjera publike dhe private, kanë përgatitur edhe një memorandum prej 6 pikash, i cili do të lexohet nga kolegët dhe do të publikohet pas përfundimit të marshit. Ju ftoj të gjithëve që të na bashkoheni", tha ai.

Donart Humolli nga Parlamenti Studentor, u shpreh se ndiejnë detyrim moral dhe përgjegjësi qytetare që ta ngrenë zërin ndaj një vendimi që e konsiderojnë krejtësisht të padrejtë.

Disa nga kërkesat e studentëve janë edhe mbështetja financiare e pakushtëzuar, si dhe mbështetja e plotë politike e morale për të akuzuarit.

"Njëkohësisht, kërkojmë hetim dhe monitorim të detajuar të procesit gjyqësor në Hagë nga organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Besojmë fuqimisht se ky vendim dënues ka qenë i padrejtë dhe bie ndesh me parimet e drejtësisë, duke cenuar vetë themelet e historisë sonë të lavdishme çlirimtare dhe luftës sonë mbrojtëse. Një proces i tillë meriton transparencë maksimale dhe syrin vigjilent të botës demokratike, për të garantuar se nuk po prodhohet një padrejtësi historike", tha Humolli.

Studentët kanë bërë thirrje për partitë politike që të tregojnë pjekuri dhe të gjejnë gjuhën e bashkëpunimit, në mënyrë që të vendosin unitetin mbi interesat ditore.

Nga Parlamenti Studentor kanë theksuar se, si rini, duan të riafirmojnë se nuk e kanë humbur besimin te drejtësia e vërtetë perëndimore.

Mbrëmjen e së dielës, protestuesit vijuan marshimin e tyre në Prishtinë në të pestën natë radhazi./Koha

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Nis grumbullimi në Prishtinë, qindra qytetarë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së](#)

21:20 Rajoni / 5 komente

[Haradinaj ngjitet në majën e Rupës, valëvit flamurin e UÇK-së](#)

20:20 Rajoni / 2 komente

["Liri për çlirimtarët", diaspora shqiptare proteston në Vjenë kundër vendimit të Hagës](#)

18:00 Rajoni / 2 komente

Kurti kërkon strategji shtetërore pas verdiktit të Hagës: Të mbështesim Apelin dhe të reagojmë diplomatikisht

16:20 Rajoni / 10 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.